



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE

PROJEKT VENDIM

Nr. 1 datë 16.03.2023

Mbi "Dhënien e ndihmës financiare familjes së shtetasit Veli Hamid Haxhija i dëmtuar nga djegia e banesës me dt.08.02.2023 banorë i Bashkisë Vau-Dejës"

Bazueshmëria ligjore e vendimit të propozuar është:

Ligji Nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar , Ligji Nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile", VKM-së Nr.329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave, Nr.263, datë 24.05.2013 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore, financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", Udhëzimin Nr.3 dt.28.12.2016 "Për miratimin e kostos së ndërtimit të banesave nga enti kombëtar i banesave per vitin 2016, si dhe në shkresën Nr.373/1 dt.17.05.2016 të Prefekturës së Qarkut Shkodër "Në lidhje me çmimet e mobiljeve, orendive dhe pajisjeve elektroshtëpiake të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve," dhe në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.84 dt.23.12.2022 "Mbi miratimin e Buxhetit të Vitit 2023"konfirmuar nga Prefektura Shkoder me shkresën Nr.24/1 dt.12.01.2023.

Për sa më sipër, Kryetari i Bashkisë Vau - Dejës për të përballuar dëmet e shkaktuara nga zjarri i rënë në banesën e tij me dt.08.02.2023 që është banorë i fshatit Barbullush të Njësisë Administrative Bushat të Bashkisë Vau-Dejës, i propozon Këshillit Bashkiak që me shumicë votash:

V E N D O S I :

1. Të miratojë proces verbalin e konstatimit të gjendjes dhe dokumentacionin e vlerësimit të dëmeve , relacionin teknik të hartuar nga inxhinieri i grupit të punës në vlerën totale **5.074.056** lekë (Pesë milion e shtatëdhjetë e kater mijë e pesëdhjetë e gjashtë) lekë për shtetasin **Veli Hamid Haxhija** banorë i fshatit Barbullush të Njësisë Administrative Bushat të Bashkisë Vau-Dejës.
2. Miratimin e dhënies së ndihmës financiarë për shtetasin **Veli Hamid Haxhija** banorë i fshatit Barbullush të Njësisë Administrative Bushat të Bashkisë Vau-Dejës me shumën **2.537.028** (Dymilion e pesëqind e tridhjetë e shtatëmijë e njëzet e tetë) lekë në masën **50%** të vlerës totale të dëmit për të përballuar dëmet e shkaktuara në banesën e tij nga djegia e banesës me dt.08.02.2023.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

3. **Efektet:** Krijon lehtësira për përballimin e situatës emergjente të banorit të dëmtuar.
4. **Burimi i financimit** do të jetë fondi i planifikuar në programin “Emergjencat Civile “i cili është miratuar në Buxhetin e Bashkisë e në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.84 dt.23.12.2022 “Mbi miratimin e Buxhetit të Vitit 2023”konfirmuar nga Prefektura Shkoder me shkresën Nr.24/1 dt.12.01.2023.

Konfirmoi bazen ligjore
Zushko Shtatu

Konceptoi

Valjeta Nikaj

Valjeta Nikaj


KRYETARI

Mark Babani



LETËRIM

REPUBLIKA E SHQIPERISE REPUBLIC OF ALBANIA



mbiemri/surname

Haxhija

emri/given name

Veli

shqetesia/nationality

Shqiptare/Albanian

vendndaj/plate of birth

Barbullush, ALB

dselindja/date of birth

15-11-1938

data e lëshimit/date of issue

08-03-2019

autoriteti lëshues/authority

MPB

firma/signature

nr. letërnjoftim/card no.

034019273

gjinia/sex

M

data e skadimit/date of expiry

07-03-2029

nr. personal/personal no.

081115019J





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJES

SEKTORI I MZSH-së

Vau Dejës me 06.03.2023

VËRTETIM NR 2

Për rënie zjarri

Vërtetohet se me datë 07.02.2023 në orën 21.58 në adresën :fshati Barbullush i Njësisë Administrative Bushat të Bashkisë Vau-Dejës , është djegur një banesë 1 katëshe e vjetër në pronësi të z.Veli Haxhija.

Si pasojë e zjarrit të rënë është djegur krejtësisht banesa 1 kateshe e vjeter me çati druri e mbuluar me tjegulla vendi .Për shuarjen e zjarrit kane marrë pjesë personeli i MZSH-së Bashkisë Vau-Dejës me komandant turni Klodian Gjoni. Nga ndërhyrja u bë e mundur: Shpëtimi i pjesës ngjitur me banesën që përdorej si magazinë me mjete bujqësore dhe bazë ushqimore për blegtorinë.

Stacioni i MZSH-së disponon dokumentacionin përkatës që verteton rënien e këtij zjarri .

Ky vërtetim mbahet në tre kopje dhe përpilohet me kërkesën e të interesuarve për ta përdorur sipas nevojës.

Anëtar

Komandanti i turnit

Klodian Gjoni

Shefi i MZSH-së

Leonard Dodani







REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
KRYETARI

Nr. 809 Prot

Datë 10 / 02 / 2023

URDHËR
Nr. 50 datë 10 / 02 / 2023

Për "Ngritje komisioni"

Mbështetur në ligjin Nr.45/2019 datë 18.07.2019 "Për mbrojtjen Civile", VKM-së Nr.329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", Udhëzimi Nr.1185/1 "Për kriteret, rregullat dhe procedurat e përdorimit të fondit të Emergjencave Civile planifikuar në buxhetin vjetor të Ministrisë së Punëve të Brendshme", i ndryshuar, për verifikimin e rastit të dëmtimit nga zjarri i rëne me datën 07.02.2023 në banesën e shtetasit **Veli Haxhija** banorë i fshatit Barbullush të Njësisë Administrative Bushat të Bashkisë Vau-Dejës

URDHËROJ:

1. Ngritjen e komisionit të mëposhtëm për verifikimin e e rastit të dëmtimit nga zjarri të banesës së shtetasit **Veli Haxhija** banorë i fshatit Barbullush të Njësisë Administrative Bushat :

✚ Valjeta Nikaj
✚ Lazër Gjergji
✚ Ardian Firza

Kryetare
Anëtar
Anetar

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhëri komisioni i lartpërmendur.
3. Afati për përpilimin e proces verbalit të konstatimit dhe të vlerësimit të rastit është data 15 / 02 / 2023.
4. **Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.**

Konceptoi
Valjeta NIKAJ

KRYETARI
Mark **BABANI**



Relacion

Objekti: “Ndërtese (banesë) 1 katëshe me çati në pronësi të z. Veli Haxhija”

Vendodhja: Barbullush ,Nj.A, Bushat , Z.K 1100 , nr. pas 515/4, Bashkia Vau-Dejes

Bazuar në urdhin e punës të ngritur nga titullari i bashkisë Vau Dejës me nr. 50 datë 10.02.2023, grupi i punës verifikoi gjendjen në banesën e z. Veli Haxhija

Banesa ndodhet në fshatin Barbullush të Njësisë Administrative Bushat , në zonën kadastrale 1100 dhe numër pasurie 515/4. Z. Veli Haxhija nuk disponon certifikatë pronësie për këtë objekt, por ka aktin e marrjes së tokës në pronësi sipas ligjit nr.7501/1991 (AMTP).

Gjatë inspektimit në terren u kryen matjet e banesës, nga të cilat rezultoi se banesa është me përmasa (sipas planimetrisë bashkëngjitur) , me sipërfaqe totale rreth 138 m². Banesa është e ndërtuar me mur guri, i cili edhe pse është i përfshirë nga zjarri nuk paraqet dëmtime strukturore, përveç rënies dhe dëmtimit të suvatimeve. Çatia ka qenë prej druri, por si shkak i zjarrit është degraduar komplet. Gjithashtu vihet re se ndarjet e brendshme të shtëpisë, të cilat nga fotot e paraqitura nga pronari i banesës kanë qenë me mur guri, kanë pësuar dëmtime të pjesshme nga zjarri. Zjarri gjithashtu ka përfshirë edhe dritaret duralumini, dyert e brendshme të objektit, si dhe derën e jashtme e cila ka qenë derë druri. Në kushte të tilla, kjo banesë në kushtet e paraqitura më sipër është e pabunueshme.

Në vlerësimin e dëmeve të objektit, janë marrë parasysh çmimet e referencës nga Enti Kombëtar i Banesave, si dhe në përzgjedhja e zërave të punës është bërë në mënyrë të tillë, që banesa të rikthehet në gjendjen e saj fillestare, para se të përfshihej nga zjarri. Punimet ndërtimore që duhet të kryhen në këtë banesë janë si më poshtë:

Brez betonarme C16/20

Çati me tjegulla vend, K.D, h.d-6m, vendi/importi

Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 1 shtrese katrama

Suvatim i brendshëm

Suvatim i jashtëm

Suvatim xokoli

Lyerje me boje plastike

F.V Dritare d/alumini rreshqitese dopio xham

Dyer te brendshme

Dyer te jashme te blinduara veshur me rimeso

Vlera e punimeve ndërtimore të përlogaritura është $138 \text{ m}^2 \times 32.642 \text{ lek/m}^2 = 4.504.596$ lekë pa TVSH bazuar në Udhëzimin Nr.3 dt.28.12.2016 "Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga enti kombëtar i banesave.

Punoi : Ing. Lazer Gjergji





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU-DEJËS
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. 50/1 Prot

Vau Dejës, me... 17.02 /2023

PROCES VERBAL KONSTATIMI

I Mbajtur sot me datë **14.02.2023** në fshatin Barbullush të Njësisë Administrative Bushat të Bashkisë Vau-Dejës nga komisioni i ngritur me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë **Nr.50 dt.10.02.2023** për konstatimin e kërkesës me nr praktike 343 dt.09.02.2023 të shtetasit **Veli Haxhija** mbi rënien e zjarrit në banesën e tij me dt.08.02.2023.

Gjatë verifikimit në vend u konstatua:

Banesa është ndërtesë 1 katëshe me çati e mbuluar me tjegull vendi e ndërtuar në vitin 1962., Banesa ka një sipërfaqe 138 m² (sipas planimetrisë bashkëngjitur)

Zjarri i rënë në banesën e shtetasit Veli Haxhija me dt.08.02.2023, ka dëmtuar plotësisht banesën ku fatmirësisht nuk ka humbje jetësh. Banesa është dëmtuar plotësisht nga ana ndërtimore (çatia, dyshemeja tavani). Gjithashtu janë dëmtuar plotësisht të gjitha mobileritë, orënditë dhe pajisjet elektro-shtëpiake si më poshtë:

Nr	Emertimi	Sasia (copë)
1	Televizor LG 32"	1
2.	Frigorifer LG 303L	1
3.	Frigorifer Samsung A1ZTSLI	1
4.	Sobe Gorenje	1
5.	Lavatriçe LG	1
6.	Komplet kolltuqe	1
7.	Minibare	1
8.	Etazher	1
9.	Tavoline mesi	1
10.	Tavoline TV	1
11.	Tavoline buke	1

12.	Karrige me tapiceri	4
13.	Dhome gjumi matrimoniale	1
14.	Dyshek doppio	1

Bashkëlidhur këtij proces verbali do të gjeni edhe kopjen e Relacionit teknik & Planimetrisë së banesës së shtetasit Veli Hamid Haxhija banorë në fshatin Barbullush të Njësisë Administrative Bushat të Bashkisë Vau-Dejës.

KOMISIONI

Valjeta Nikaj

Lazer Gjergji

Ardian Firza

MIRATO HET
KRYETARI
Mark BABANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU-DEJES
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE

Vau-Dejes, me 14.02.2023

MIRATOHET

KRYETARI
Mark BABANI



Vlerësimi i dëmeve në mobileri, orendi, pajisje elektroshtëpiake

Në mbështetje të V.K.M Nr. 329, datë 16/05/2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, vlerësimi i dëmeve sipas komisionit të vlerësimit për: mobileri ,orendi, pajisje elektro-shtëpiake të dëmtuara nga zjarri në objektin e banimit të **z.Veli Hamid Haxhija**

Nr	Emertimi	Sasia (copë)	Çmimi	Vlera
1.	Televizor Samsung 32”	1	49.000	49.000
2.	Frigorifer LG 303L	1	52.260	52.260
3.	Frigorifer Samsung A1ZTSLI	1	79.800	79.800
4.	Sobe Gorenje	1	41.100	41.100
5.	Lavatriçe LG	1	44.400	44.400
6.	Komplet kolltuqe	1	48.300	48.300
7.	Minibare	1	32.000	32.000
8.	Etazher	1	11.000	11.000
9.	Tavoline mesi	1	10.000	10.000
10.	Tavoline TV	1	6.700	6.700
11.	Tavoline buke	1	18.000	18.000
12.	Karrige me tapiceri	4	2.200	8.800
13.	Dhome gjumi matrimoniale	1	155.000	155.000
14.	Dyshek dopio	1	13.100	13.100
Shuma				569.460

Vlerësimi i mobiljeve, orendive dhe pajisjeve elektroshtëpiake është bërë në bazë të shkresës Nr.373/1 dt.17.05.2016 të Prefekturës së Qarkut Shkodër “Në lidhje me çmimet e mobiljeve, orendive dhe pajisjeve elektroshtëpiake të dërguara nga Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve”

Vlerësimi i zërave të punimeve është bërë në mbështetje të V.K.M Nr. 329, datë 16/05/2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, kapitulli III, pika 2 germa ç, si dhe Udhëzimin Nr.3 dt.28.12.2016 “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga enti kombëtar i banesave për vitin 2016, ku vlera e objektit të dëmtuar është **4.504.596** lekww sipas


relacionit të hartuar nga ing.Lazer Gjergji, ndërsa vlera e dëmeve në mobilje, orendi dhe pajisjeve elektroshtëpiake është **569.460** lekë, ku vlera totale e dëmit është **5.074.056** lekë .

Komisioni:

Valjeta Nikaj



Lazer Gjergji



Ardian Firza

